



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:061355

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05784028

KPPP.nr. 43/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) Sh.A., me numër unik identifikues 811380617 dhe me seli në Prishtinë, rr. "Bekim Fehmiu", nr. 137, kundër debitorit KRM "Pastrimi" Sh.A., me numër unik identifikues 811276957 dhe me seli Prishtinë, rr. "Bill Clinton", nr. 5, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 252/22 i datës 22.12.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Shala nga Prishtina, pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datë 16.05.2024 në prezencë të palëve ndërgjyqëse, me datë 05.06.2024, merr këtë

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit KRM "Pastrimi" Sh.A., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 252/22 i datës 22.12.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Isa Shala, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK) Sh.A., me datë 22.12.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 252/22, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 13Ko21, e datës 03.08.2021; Faturës nr. 10/Pr22, e datës 06.05.2022; Faturës nr. 12/Maj22, e datës 02.06.2022; Faturës nr. 03/Qer22, e datës 04.07.2022; Faturës nr. 17/Korr22, e datës 03.08.2022; Faturës nr. 13/Gu22, e datës 02.09.2022; Faturës nr. 16/Shtat22, e datës 05.10.2022; Faturës nr. 06/Tet22, e datës 03.11.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që, në afatin prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguajë kreditorit shumën e borxhit sipas faturave të lartcekura në lartësi prej EUR 535,833.08

(pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre euro e tetë euro cent), me kamatë vonesë nga dita kur është dashur të përmbushet detyrimi, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se nuk është kontestues fakti që nuk ka përmbushur detyrimet ndaj kreditorit, si dhe ka bërë përpjekje për realizimin e borxhit me këste mujore sipas marrëveshjes së ri programimit me kreditorin. Më tej, ka theksuar se me rastin e dërgimit të mbeturinave në deponi nuk është bërë identifikimi, ndarja dhe klasifikimi i tyre, ashtu që tarifa me rastin e deponimit të mbeturinave është caktuar në mënyrë paushallë. Ka shtuar se në faturat mujore të pranuar ka pasur mospërputhje dhe pasaktësi, ku debitori është faturuar në mënyrë të pasaktë në shumë rreth 8,000.00 €, mirëpo korrigjimi i të njëjtave fatura mund të bëhet me rastin e nënshkrimit eventual të një aneksi të marrëveshjes për ri programimin e borxhit, e që kontestimi i tyre nuk nënkupton edhe kontestim të borxhit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të shtyhet së zbatuari urdhri përbarimor P.nr. 252/22, i datës 22.12.2022 deri në evitimin e pasaktësive të faturave dhe si realizimit të kontratës së re të ri programimit, me të cilën debitori pranon realizimin e borxhit.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetim se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të dokumenteve të cilat i plotësojnë të gjitha kriteret ligjore sipas dispozitave ligjore, e për më tepër debitori në prapësim nuk ka kontestuar obligimin financiar që ka ndaj kreditorit. Ka shtuar se debitori ka paraqitur prapësimin vetëm sa për të zvarritur procedurën ku dëshmohet fakti se të gjitha pretendimet e paraqitura në prapësim janë të pa bazuara dhe të pa mbështetura në prova. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, me qëllim të shqyrtimit të validitetit të prapësimin, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore me datë 16.05.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse.

Përfaqësuesi i debitorit, në seancën dëgjimore ka deklaruar se mbetet pranë prapësimin të datës 30.12.2022, pasi që faturat e lëshuara nga ana e kreditorit të cilat nuk janë pranuar nga ana e debitorit, nuk janë dokumente të besueshme sipas nenit 29 të LPP-së, dhe nuk kanë titull ekzekutiv, respektivisht nuk kanë tipare të përbarueshmërisë. Më tej, ka theksuar se

Përmbartuesi Privat me rastin e lejimit të Urdhrit Përmbartimor, ka vepruar në kundërshtim me nenin 21 të LPP-së, ngase organi përmbartues e cakton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues dhe dokumentit të besueshëm. Andaj, faturat të cilat potencohen si dokument i besueshëm nga ana e kreditorit janë të pa nënshkruara nga debitori si dhe të pa protokolluara nga ana e debitorit.

Përfaqësuesi i kreditorit, në seancë dëgjimore ka theksuar se debitori në prapësim ka pranuar që i ka pranuar faturat me kohë por nuk i ka kontestuar dhe as reklamuar me kohë. Ka shtuar se po ashtu debitori nuk e ka kontestuar borxhin, për më tepër më datë 28 mars 2024 ka pasur një takim në mes të dy menaxhmenteve ku në tërësi dhe pa asnjë kusht lidhur me kontestimin e faturimit është pranuar borxhi prej 500,000.00 EUR nga debitori, ku në pikën 3 të marrëveshjes thuhet shprehimisht se KRM Pastrimi gjatë muajit prill 2024, të gjitha inkasimet e veta do t'i paguajë tek kreditori në emër të borxhit. Më tej, ka theksuar se në po të njëjtën marrëveshje përmendet edhe vendimi i Kuvendit Komunal i datës 02.11.2023, me vendim të cilit KRM Pastrimi i ka kërkuar aksionarit të vet 500,000.00 EUR, për mbulimin e borxhit për pagesën për shlyerjen e borxhit të tarifës së mbeturinave, ashtu që marrëveshja është e përpiluar dhe nënshkruar nga debitori, si dhe nuk kontestohen faturat dhe debitori nuk ka asnjë vërejtje sa i përket faturimit. Në fund, ka kërkuar nga gjykata që prapësimi i debitorit të refuzohet, ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 13Ko21, e datës 03.08.2021, fatura nr. 10/Pr22, e datës 06.05.2022, fatura nr. 12/Maj22, e datës 02.06.2022, fatura nr. 03/Quer22, e datës 04.07.2022, fatura nr. 17/Korr22, e datës 03.08.2022, fatura nr. 13/Gu22, e datës 02.09.2022, fatura nr. 16/Shtat22, e datës 05.10.2022, fatura nr. 06/Tet22, e datës 03.11.2022, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se përkundër faktit që faturat e lartcekura nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit, debitori ka qenë i njoftuar për faturat kontestuese dhe detyrimet që derivojnë nga to, fakt ky të cilin gjykata e vërtetoi nga kartela financiare e përpiluar nga vet pala debitore dhe e dorëzuar nga kreditori si provë në seancën gjyqësore, nga e cila vërtetohet që si pjesë e kartelës financiare të vet debitorit, evidentohen edhe faturat objekt i këtij përbarimi.

Për më tepër, nga procesverbali i datës 28.03.2024 i dorëzuar si provë nga kreditori, gjykata gjeti se palët ndërgjyqëse, pas pranimit të ftesës për seancë dëgjimore lidhur me këtë çështje përbarimore, kanë pasur takim të përbashkët për adresimin e borxheve të akumuluar mes kreditorit dhe debitorit, ashtu që janë pajtuar që lidhur me borxhin që debitori ka për kreditorin, i njëjti të paguaj fillimisht shumën prej 100,000.00 EUR nga të hyrat e rregullta, dhe se palët janë dakorduar që debitori të gjitha parat e inkasuara nga borxhet e akumuluar do t'i kanalizojë për mbulimin e borxhit të akumuluar. Në drejtim të kësaj, nga vendimi i Komunës së Prishtinës i datës 02.11.2023, si aksionar i vetëm i debitorit, vërtetohet se debitorit, konkretisht KRM "Pastrimi" Sh.A., i është ndarë shuma prej 500,000.00 EUR me qëllim të fshirjes së borxhit për pagesën e tarifës së deponisë së mbeturinave.

Andaj, mungesa e nënshkrimit dhe vulës së debitorit në faturat e bashkangjitura në propozimin për përbarim, nuk mund të shërbej si arsyetim për debitorin se i njëjti nuk ka qenë në dijeni lidhur me të njëjtat, kjo përderisa vet debitori, në kartelën e llogarive të tij, ka evidentuar faturat në fjalë dhe detyrimet e pa përmbushura për kreditorin, se lidhur me këtë borxh, ka arritur marrëveshje me kreditorin për pagesë, e po ashtu nisur nga fakti se debitori, ka kërkuar ndihmë buxhetore nga aksionari i saj Komuna e Prishtinës për mbulimin e borxheve ndaj kreditorit.

Duke qenë se debitori ka konfirmuar borxhin që rrjedh nga faturat që janë objekt i procedurës përmbartimore, dhe meqenëse debitori nuk ka paraqitur asnjë provë edhe në seancat gjyqësore ashtu siç përcaktohet me nenin 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve taksative të parapara me nenin 71 të LPP-së për mbështetje të prapësimit, u vendos që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të mbetet në fuqi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 43/23, datë 05.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.